



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____._____.2026

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri Bashkia Mat
Adresa Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel
Tel/Fax 0685086246
E-mail eduart.abazi@gmail.com
Ueb-faqe www.bashkiamat.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “E Hapur, E Thjeshtuar - Shërbime”, prokurim elektronik.

3. Numri i referencës së procedurës: REF-93369-07-14-2026

Numri i referencës së Lotit 1: REF-93374-07-14-2026

Numri i referencës së Lotit 2: REF-93377-07-14-2026

4. Objekti i kontratës: “Shërbimi i mbikqyrjes të punimeve ndërtimore për investimet e Bashkisë Mat, ndarë në 2-lote”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 71247000-1 Mbikëqyrja e punës së ndërtimit.

6. Fondi limit: 4 367 351.74 (katër milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin 2026 në vlerën: **3 108 312.62** (tre milion e njëqind e tetë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, nga granditë: 2 315 694.29 (dy milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër pikë njëzet e nëntë) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat: 792 618.33 (shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, ndërsa për vitin 2028 në vlerën: **1 259 039.12** (një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e nëntë pikë dymbëdhjetë) **lekë pa TVSH**, i ndarë me lote si më poshtë:

- **Loti Nr. 1: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës të ushqyesit të ujëmbledhësit të Bazit nr.2 dhe degëzimi Karicë”, me fond limit në**

vlerën: **2 315 694.29** (dy milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër pikë njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, nga grand i bashkisë;

- **Loti Nr. 2: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Faza II”, me fond limit në vlerën: 2 051 657.45 (dy milion e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH nga të ardhurat, ndarë për vitin 2026 në vlerën: 792 618.33 (shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2028 në vlerën: 1 259 039.12 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e nëntë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH;**

7. Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: në përputhje me kohëzgjatjen e punimeve objekt investimi për të cilën kërkohet shërbimi i mbikqyerjes së punimeve;

- **Loti Nr. 1: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës të ushqyesit të ujëmbledhësit të Bazit nr.2 dhe degëzimi Karicë”, me afat: 9 (nëntë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).**
- **Loti Nr. 2: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Asfaltim i rrugëve lidhëse në fshatrat e Njësive Administrative Faza II”, me afat: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet për secilin nënobjekt).**

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data 27/ 07/ 2026, Ora: 10.00, në www.app.gov.al.

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____
- c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

Titullari i Autoritetit Kontraktor